

← 105-120  
**WALL ST**

***Dr. Elvin MEKA***

***UET, 2013***

***Kuptimi  
i  
Instrumenteve Financiare***

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Përmbajtja:

- Aktivet Financiare dhe Instrumentet Financiare.**
- Cilësitë e Instrumenteve Financiare.**
- Tiparet e Instrumenteve Financiare.**
- Kategoritë Kryesore të Instrumenteve Financiare.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Aktivet dhe Instrumentet Financiare

**AKTIVI - Çdo gjë e zotërueshme, që ka vlerë në këmbim.**

**Aktivet klasifikohen:**

- **Aktive të Prekshëm (të trupëzuar)**
  - Të riprodhueshme (makineri, pajisje),
  - Të pariprodhueshme (toka).
- **Aktive të Paprekshme (të patrupëzuar)**

**Paraqiten si detyrime (pretendime) ligjore kundrejt përfitimeve të ardhshme.**

  - Instrumentet Financiare

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Aktivet dhe Instrumentet Financiare

### Karakteristikat e përbashkëta të Aktiveve:

- ❑ Sigurimin e të ardhurave për zotëruesit e tyre.
- ❑ Aktivet e prekshme mund të financohen nga emetimi i disa aktiveve të patrupëzuar në formë:
  - ❖ Instrumenti borxhi (obligacione),
  - ❖ Instrumenti të kapitalit të vet (aksione).

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Aktivet dhe Instrumentet Financiare

### **Emetuesi i aktivit financiar:**

**Njësia ekonomike që pranon të kryejë pagesat e ardhshme të flukseve monetare (rrjedhave të parasë).**

### **Investues në aktivin financiar:**

**Zotëruesit e aktiveve financiare.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Aktivet dhe Instrumentet Financiare

**Aktivet financiare ose instrumentet financiarë:**

- Financimi (huaja) bankare,**
- Depozitat bankare,**
- Kontratat e *leasing*-ut (qerasë financiare),**
- Titujt shtetërorë,**
- Obligacionet bankare dhe të shoqërive,**
- Aksionet.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Aktivet dhe Instrumentet Financiare

**Instrumentet Financiare** gëzojnë disa veti që lehtësojnë shitblerjen në tregjet dytësore (sekondare):

- ✓ **Standardizim të formës së kontraktimit,**
- ✓ **Rregullim juridik të qarkullimit të tyre mes investuesve.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Aktivet dhe Instrumentet Financiare

**Instrumenti Financiar nënkupton një dëshmi (çertifikatë), që shpreh marrëdhënie:**

- **borxhi të emetuesve kundrejt nënshkruesve,**
- **të pjesëmarrjes në kapitalin e vet të emetuesit.**

**Mund të jenë dhe marrëdhënie të përziera (hibride), ose marrëdhënie pozicionesh mbulimi, apo spekulimi (instrumentet derivate).**



# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Cilësitë e Instrumenteve Financiare

### *1. Mundësia për kthim në para' likuide:*

#### □ **Aktive financiare në para' likuide (cash):**

⇒ **Valutat;**

⇒ **Depozitat që ofrojnë dhe lejojnë nënshkrimin e çeqeve).**

#### □ **Aktive financiare “pothuajse para”:**

⇒ **Depozitat me afat dhe pa afat;**

⇒ **Letrat me vlerë të qeverisë me afat të shkurtër maturimi.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Cilësitë e Instrumenteve Financiare

### *2. Copëzimi dhe llojet e prerjeve:*

**Copëzimi lidhet me madhësinë minimale me të cilën mund të likuidohet, ose këmbehet në para' aktivi financiar.**

**Sa më e vogël madhësia, aq më i pjestueshëm aktivi financiar.**

**Pjestueshmëria varet nga natyra e instrumentit.**

**Cilësi e dëshirueshme për investuesit.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Cilësitë e Instrumenteve Financiare

### *3. Kthyeshmëria:*

**Është kosto tërësore që lidhen me hyrjen dhe daljen nga investimi në aktivin financiar (kosto e rikthimit).**

⇒ **Komisionet;**

⇒ **Diferenca ndërmjet çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes (BID dhe ASK), që pasqyron riskun e krijimit të tregut.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Cilësitë e Instrumenteve Financiare

### ***3. Kthyeshmëria:***

**Risku i Krijimit të Tregut varet nga:**

- **Luhatshmëria e çmimit në treg (masa e ndryshimit të çmimit përkatës në kohë);**
- **Përcaktuesin e intervalit (*spread-it*) çmim blerje – çmim shitje, që lidhet me thellësinë e tregjeve (*thickness of the market*)**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Cilësitë e Instrumenteve Financiare

### *4. Afati i Maturimit:*

**Gjatësia e intervalit kohor deri në ditën kur kryhet pagesa përfundimtare, ose kur zotëruesi ka të drejtë të kërkojë likuidimin e tij.**

- **Shlyerje në çdo kohë - instrumente të kërkueshëm për shlyerje në çdo kohë,**
- **Shlyerje të përcaktuara në kohë.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Cilësitë e Instrumenteve Financiare

### ***5. Likuiditeti:***

**Shndërrimi i aktivit financiar në para', pa pësuar humbje (ose me kosto fare minimale).**

**Likuiditeti mund të përcaktohet me marrëveshje kontraktore.**

**Likuiditeti varet nga:**

- ❖ Lloji aktivit financiar;**
- ❖ Shuma, që dikush dëshiron të blejë, ose të shesë;**
- ❖ Dendësia e shkëmbimeve në treg.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Cilësitë e Instrumenteve Financiare

### ***6. Konvertueshmëria:***

**Shndërrueshmëria e aktiveve financiare në disa aktive të tjera.**

**Shndërrimet mund të ndodhin:**

- **Brenda të njëjtës klasë aktivesh financiare;**
- **Midis klasave të ndryshme të aktiveve financiare.**

**Kushtet e konvertueshmërisë zakonisht përcaktohen në kontratë.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Cilësitë e Instrumenteve Financiare

### *7. Lloji i monedhës:*

**Aktivet financiare zakonisht shprehen dhe paguajnë detyrimet në një monedhë të vetme.**

**Disa emetues emetojnë aktive financiare ku principali (kryegjëja) dhe interesat paguhen respektivisht në monedha të ndryshme (me qëllim të uljes së riskut të këmbimit).**



# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Cilësitë e Instrumenteve Financiare

### *8. Flukset e parasë dhe parashikueshmëria e kthimit:*

**Parashikueshmëria e kthimeve varet nga parashikueshmëria e flukseve të parasë.**

**Parashikueshmëria e flukseve të parasë për aktivet financiare mundëson përlogaritjet e vlerës aktuale të tyre.**

**Flukset e parasë:**

- **Pagesa dividendësh,**
- **Pagesa interesash dhe shlyerje të vlerës nominale për instrumente borxhi.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Cilësitë e Instrumenteve Financiare

### *9. Shkalla e kompleksitetit:*

**Aktivet financiare mund të jenë të thjeshta ose të përbëra.**

**Vlerësimi i këtyre aktiveve bëhet duke i “shpërbërë” në aktive më të thjeshta që e përbëjnë atë.**

**Aktualisht ekziston një gamë e gjerë instrumentesh borxhi shumë komplekse.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Cilësitë e Instrumenteve Financiare

### *10. Statusi tatimor:*

**Tatimi i të ardhurave të fituara nga zotërimi ose shitja e aktiveve financiare, varen nga:**

- ☞ Lloji i aktiveve,**
- ☞ Vendi dhe shteti,**
- ☞ Lloji i emetuesve,**
- ☞ Kohëzgjatja e zotërimit të aktivit,**
- ☞ Natyra e zotëruesit të aktivit.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Tiparet Dalluese të Instrumenteve Financiare

### *a) Lloji i monedhës në të cilën shprehen:*

**Përcaktimi i njësisë monetare, në të cilën duhen shprehur rrjedhat e ardhshme të pagesave.**

### *b) Natyra e emetuesit:*

**Përcakton riskun e mospërbushjes së detyrimeve të marra përsipër.**

**Emetues të ndryshëm kanë natyra dhe profile risku të ndryshëm.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Tiparet Dalluese të Instrumenteve Financiare

### *c) Jetëgjatësia e kontratës:*

**Horizonti kohor i operacionit financiar, ose periudha e angazhimit të kapitalit.**

- **E papërcaktuar (çasti i shlyerjes)  
(aksionet ose obligacionet e përjetshme)**
- **E përcaktuar (çasti i shlyerjes).**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Tiparet Dalluese të Instrumenteve Financiare

### *d) Mënyra e kryerjes së shërbimit:*

*d1) Kushtet shpërndarjes së kapitalit, ose të emetimit të titujve.*

*d2) Kushtet e rikthimit (shlyerjes) së kapitalit:*

- tërësisht në përfundim të afatit,
- me plan periodik shlyerjesh.
- shlyerje të parakohshme.

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Tiparet Dalluese të Instrumenteve Financiare

*d2) Kushtet e rikthimit (shlyerjes) së kapitalit:*

**Këto elementë ndikojnë në:**

- **përcaktimin e frekuencave kohore të pagesave;**
- **Klasifikimin e aktiveve financiare sipas afateve të matimit (afatshkurtra, me afat mbi 1 vit dhe afatgjata).**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Tiparet Dalluese të Instrumenteve Financiare

*d3) Tipi dhe natyra e shpërblimit për kapitalin e investuar:*

**Shpërblimi mund të jetë në formë:**

❖ **Dividendi (aksionet):**

*Luhatshmëria e këtij shpërblimi varet nga ecuria e shoqërisë dhe politika e dividendit.*

❖ **Interesi (obligacionet):**

*Përgjithësisht fiksohet në kontratë, që në momentin e emetimit, edhe në rastet e obligacioneve të indeksueshme.*



# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Tiparet Dalluese të Instrumenteve Financiare

### *d4) Mundësi dhe Opsione të Veçanta:*

- **Mundësia e kërkimit të shlyerjes së parakohshme,**
- **ndryshimi i skemës dhe nivelit të shpërblimit,**
- **Ndryshimi i kontratës fillestare.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Tiparet Dalluese të Instrumenteve Financiare

### *e) Trajtimi fiskal:*

- ➔ **I tërthortë mbi transferimet e pronësisë.**
- ➔ **I drejtpërdrejtë mbi të ardhurat e siguruara.**

**Në varësi të subjekteve përfituese dhe llojit të instrumentit.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Tiparet Dalluese të Instrumenteve Financiare

### *f) Likuiditeti i instrumentit:*

**Aftësia për t'u shndërruar në mjete pagese, nëpërmjet daljes nga investimi (çlirimi) para afatit të rregullt të maturimit. Përcaktohet nga:**

- **Natyra e emetuesit,**
- **Jetëgjatësia e titullit,**
- **Shpërblimi që ofron instrumenti.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Tiparet Dalluese të Instrumenteve Financiare

### *f) Likuiditeti i instrumentit:*

***Likuiditeti natyral*** – përcaktohet në kontratë.

***Likuiditeti artificial*** – përcaktohet në treg.

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Kategoritë Kryesore të Instrumenteve Financiare

- 1. Instrumente Financiare të Borxhit (të ardhura fikse),**
- 2. Instrumente Financiare të Kapitalit (të ardhura të ndryshueshme),**
- 3. Instrumente Financiare të shartuar (hibridë),**
- 4. Instrumente Financiare derivate.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Kategoritë Kryesore të Instrumenteve Financiare

### ***Aksionet:***

- 1. Ndarje të barabartë kapitali,**
- 2. Te drejta te barabarta**
- 3. Nuk emetohet për shuma më të ulta se vlera nominale,**
- 4. I papjestueshëm,**
- 5. Të ardhura të ndryshueshme.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Kategoritë Kryesore të Instrumenteve Financiare

### *Përfitimet nga Aksionet:*

- 1. Rivlerësimi në tregun dytësor,**
- 2. Shpërndarja e aksioneve falas,**
- 3. Nga blerja nga ana e zotëruesve kryesorë të aksioneve të shoqërisë,**
- 4. Ushtrimi i opsioneve për blerje aksionesh të shoqërisë.**

# KUPTIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE

## Kategoritë Kryesore të Instrumenteve Financiare

### ***Obligacionet:***

- 1. Të ardhura përgjithësisht të pandryshueshme,**
- 2. Te garantuara.**

### **Instrumentet e shartuara (hibride):**

- **Aksioni i preferuar (të ardhura të pandryshuara),**
- **Obligacioni i konvertueshëm.**